



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION

PËR
PROJEKTLIGJIN

“PËR
KRIJIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE ARSIMORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për organizimin e funksionimit, detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, si institucion autonom dhe nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin që ka për mision garantimin e interesit publik në ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit, profesioneve të rregulluara, vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, nxitjen me synimin e përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe krijimin e kushteve të favorshme në interes të publikut.

Objekti i këtij projektligji është krijimi i Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, përcaktimi i fushës së saj të veprimtarisë, i parimeve dhe rregullave të përgjithshme të organizimit e të funksionimit, si dhe të detyrave dhe kompetencave të saj.

Aktualisht funksionet që parashikohet të ketë agjencia kryhen një pjesë e tyre nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), e cila e ushtron veprimtarinë e saj, si institucion nën varësinë e ministrit përgjegjës për arsimin. Reformimi i Qendrës së Shërbimeve Arsimore ka për qëllim ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar, si dhe çdo shërbim tjetër të caktuar sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet përmirësimit të formës së saj të organizimit institucional, bazuar në *ritjen e cilësisë së funksionimit të saj si institucion i administratës shtetërore*.

Bazuar në nenin 9, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Qendra

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore”

e Shërbimeve Arsimore (QSHA), është institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin. Po në këtë nen, është përcaktuar misioni dhe objekti i veprimtarisë së QSHA, për ofrimin e shërbimeve, në fushën e arsimit të lartë. Gjithashtu, funksionet e QSHA, të cilat përcaktohen në nenin 10, të ligjit nr. 80/2015, janë të përcaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë institucion dhe jo për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Shkronja d), e pikës 1, të këtij neni, i njeh të drejtën ministrisë përgjegjëse për arsimin, të ngarkojë QSHA-në me çdo shërbim, të ndryshëm nga ato që parashikohen në këtë dispozitë, brenda fushës së saj të përgjegjësisë.

Një nga funksionet e QSHA-së të parashikuara në nenin 10, pika 1, shkronja ç të ligjit nr. 80/2015, është administrimi dhe organizimi i provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, në bashkëpunim me organet kompetente përkatëse. Profesionet e rregulluara, rregullohen me ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në përmbushje të detyrimit për organizimin e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, QSHA bashkëpunon me autoritet përkatëse, të cilat janë të rregulluara me ligje të posaçme. Në nenin 10, të ligjit nr. 10 171/2009, i ndryshuar, parashikohet që provimi i shtetit organizohet dhe zhvillohet nga ministria që mbulon fushën e arsimit, në bashkëpunim me autoritetin kompetent përkatës. Ky nen përcakton dhe procedurat dhe kriteret mbi zhvillimin e provimit të shtetit.

Sa më sipër, konstatohet që dy akte ligjore të ndryshme, ngarkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për të njëjtin funksion (shërbim), dy institucione të ndryshme dhe pse QSHA është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në nenin 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: “1. Në provimet kombëtare të arsimit bazë nxënësit vlerësohen në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët gjuhë amtare, gjuhë shqipe, matematikë dhe, sipas dëshirës, edhe në një gjuhë të huaj. 3. Organizimi e zhvillimi i vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe i provimeve kombëtare të arsimit bazë rregullohen me udhëzim të ministrit”.

Në nenin 51 të këtij ligji parashikohet: “Arsimi i mesëm i lartë përfundon me provimet e maturës shtetërore. Në provimet e maturës shtetërore nxënësit japin

një numër lëndësh të përbashkëta dhe një numër lëndësh me zgjedhje. Të gjithë nxënësit kanë këto tre lëndë të përbashkëta: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe një gjuhë e huaj. Lëndët me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve kombëtare të maturës shtetërore rregullohen me udhëzim të ministrit.

Në nenin 52 të këtij ligji parashikohet: “1. Dokumenti i përfundimit të arsimit bazë është dëftesa e arsimit bazë, e cila lëshohet nga drejtori i shkollës pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë. Dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është diploma e maturës shtetërore, e cila lëshohet nga institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore. 2. Në përfundim të çdo klase, nxënësi pajiset me dëftesë klase. Kriteret për lëshimin e dëftesës përcaktohen me udhëzim të ministrit. 3. Shkolla private e arsimit të mesëm të lartë e licencuar mund të lëshojë diplomë të një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të. Ministri përcakton procedurat e njësimit të këtyre diplomave. 4. Kriteret dhe procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit përcaktohen me udhëzim të ministrit”.

Po ashtu, në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, i ndryshuar, përcaktohen dhe kompetencat e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe të agjencive në varësi të saj, për zbatimin e këtij ligji.

Gjithashtu, në nenin 92, të ligjit për arsimin e lartë, përcaktohet si institucioni përgjegjës për njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit, ministria përgjegjëse për arsimin, e cila me udhëzim ia ka deleguar këtë kompetencë QSHA-së.

Pavarësisht, parashikimit të mësipërme, me ligjin e krijimit të agjencisë si agjenci autonome shtetërore, do të mund të rregullohen parashikimet në ligjet e mësipërme, si misioni, objekti dhe funksionet e saj, në një fushë më të gjerë se arsimi i lartë dhe arsimi parauniversitar, duke e bërë të pazbatueshëm shkronjën d), të pikës 1, të nenit 10 të ligjit për arsimin e lartë, nisur dhe nga parimi “lex specialis derogat generali”, që do të thotë së rregullat e posaçme prevalojnë mbi rregullat e përgjithshme. Këtë rregullim e gjejmë dhe në vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se në rastet kur në një gjykim zbatohen njëkohësisht dy ligje (materiale apo procedurale), atëherë do të

zbatohet ligji i posaçëm për ai ka prioritet mbi ligjin e përgjithshëm. Bazuar nga kjo, ligji për krijimin e agjencisë do të jetë ligji i posaçëm.

Funksionet e përcaktuara për QSHA-në, në ligjet aktuale të përmendura më sipër, mund të përthithen në aktin e krijimit të agjencisë, pasi janë funksione dhe kompetenca që ngarkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë QSHA-në dhe jo ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Sa më sipër në ligjin e posaçëm për ngritjen e një agjencisë do të parashikohen detyrat dhe funksionet agjencisë së shërbimeve arsimore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 68/2021 "Për miratimin e përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave".

Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" (SKA 2021-2026).

Ky projektakt nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t'u miratuar në vitin 2025, në zbatim të vendimit nr. 818, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025".

Bazuar në nenin 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i ndryshuar që përcaktojnë rregulla për veprimtaritë publike të institucioneve në periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve, ky projektligj nuk përcakton

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore"

zhvillimin e veprimtarive të ndaluar për t'u promovuar, me të cilat konsiderohen ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Ky projektligj, që propozohet për miratim, nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i ndryshuar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EULEKTET E PRITSHME

Aktualisht funksionet që parashikohet të ketë agjencia kryhen një pjesë e tyre nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), e cila e ushtron veprimtarinë e saj, si institucion nën varësinë e ministrit përgjegjës për arsimin që ofron shërbime në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e arsimit parauniversitar, e cila ka si qëllim të saj përmirësimin e ofrimit të shërbimeve arsimore, si dhe sigurimin e një procesi vlerësimi dhe monitorimi të testeve, vlerësimeve dhe provimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në sistemin arsimor, për të qenë sa më eficient, të pavarur dhe transparent, në përputhje me politikat shtetërore arsimore dhe standardet ndërkombëtare në arsim.

Garantimi i shërbimeve për qytetarët, nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, institucionet e arsimit parauniversitar, institucionet e arsimit të lartë (IAL), urdhrat profesionale, institucionet dhe të tretët, duke ushtruar në këtë lloj forme funksionin e saj teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave arsimore, mund të realizohet nga ky institucion në një nga format e organizmit të institucioneve të administratës shtetërore të përcaktuara në ligjin nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Forma më e mirë e organizimit sipas këtij ligji, vlerësojmë se përcaktohet bazuar në një analizë të realizimit të funksioneve që aktualisht ofrohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në fushat që ajo mbulon duke referuar

realizimin e secilit funksion sipas një forme më të përshtatshme të institucioneve të administratës shtetërore.

Deri më sot, veprimtaria e Qendrës së Shërbimeve Arsimore është mbështetur kryesisht në fushën e arsimit, por ka ofruar edhe shërbime të tjera si provimet e shtetit për profesionet e regulluara, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe profesione që lidhen me ministritë e tjera. Po ashtu, ajo ofron edhe shërbime të provimeve të digjitalizuara si p.sh provimi për pranimin në programi e integruar të ciklit të dytë PIND në Mjekësi e Përgjithshme.

Në këtë kuadër, është i nevojshëm krijimi i strukturave të posaçme shtetërore me qëllim realizimin e qëllimeve dhe ushtrimin e suksesshëm dhe në mënyrë autonome të funksioneve të saj, në saj të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe harmonizimit të veprimtarisë së saj me institucionet publike dhe private të arsimit si dhe me organet e tjera shtetërore.

Krijimi i agjencisë së re në fushën e shërbimeve arsimore përbën një hap të rëndësishëm në plotësimin e nevojave në fushën e arsimit dhe përmbushjen e objektivave konkrete e të arritshme. Hartimi i projektligjit synon të theksojë rolin e agjencisë në kuadër të funksionimit dhe organizimit të saj në përputhje me normat dhe rregullat e parashikuara në legjislacionin e brendshëm, si dhe duke pasur në konsideratë edhe standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të ndërmarra në fushën e shërbimeve arsimore.

Pavarësisht se baza ligjore aktuale, ka parashikuar në akte të ndryshme procedurën e organizimit dhe funksionimit të QSHA-së, si rezultat i propozimit të këtij projektligji në saj të krijimit të një agjencie të re, do të krijohet mundësia e rregullimit të saj me një akt të vetëm me qëllim ofrimin e shërbimeve arsimore në mënyrë autonome.

Nisur nga nevoja për autonominë në ofrimin e shërbimeve arsimore në kuadër të meritokracisë është ndërmarrë nisma ligjore për të ndryshuar statusin juridik të QSHA duke e shndërruar nga një institucion në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, në agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin, bazuar edhe në përcaktimet e ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Në vijim të propozimit për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, si agjenci autonome shtetërore, më poshtë po paraqesim analizën ligjore për krijimin e kësaj agjencie si dhe aktet ligjore me të cilat do të ndërveprojë.

Në nenin 25 të Kodit Civil, parashikohet se: "Persona juridikë publike janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Prandaj, si subjekte të së drejtës në përgjithësi, dhe asaj publike në veçanti janë:

Institucioni shtetëror është personi juridik publik që gëzon katër karakteristikat kryesore të mëposhtme, si:

- personalitetin juridik, e drejta për të pasur të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime dhe që lidhet me konceptin e zotësisë juridike administrative dhe asaj për të vepruar
- unitetin organizativ, që nënkupton se institucionet ushtrojnë veprimtarinë e tyre të përfaqësuar nga organet e tyre publike, që mund të jenë individuale apo kolegjiale, si dhe mbështeten nga një strukturë organizative që mbulon aspekte të veçanta të veprimtarisë institucionale që drejtohet nga organi publik.
- pavarësinë pasurore, që do të thotë se çdo institucion publik ka pasurinë e tij e cila buron kryesisht nga buxheti i shtetit, apo nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera të realizuara prej tij.
- përgjegjësinë e pavarur pasurore, pra me buxhetin e tij që ia jep shteti po e krijon vetë në sajë të veprimtarisë së tij ai përgjigjet për dëmet që u shkakton të tretëve si rezultat i veprimtarisë së tij të paligjshme.

Objektivat kryesore të modelit të Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, të propozuar janë:

- ✓ Strategji e re afatgjatë, e bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare;
- ✓ Analizë të dhënash dhe kërkime shkencore mbi vlerësimin, mbi bazën e të cilave do të hartohen politikat arsimore;
- ✓ Përputhja e struktura dhe sistemeve të brendshme për të mbështetur krijimin e një Agjencie Kombëtare efektive dhe me impakt pozitiv në sistemin arsimor;
- ✓ Autonomi dhe Stabilitet Financiar, Qëndrueshmëria financiare – ndërtimi i stabilitetit financiar, investimi afatgjatë dhe autonomia financiare përmes produkteve dhe shërbimeve të reja.
- ✓ Standarde të njohura ndërkombëtarisht (ISO9001) dhe përmirësimi i cilësisë. Shërbime të vlerësimit sipas praktikave më të mira

ndërkombëtare duke përdorur ISO9001 – zbatimi i standardeve ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë për të implementuar praktikat më të mira në vlerësimin kombëtar.

- ✓ Vlerësimi Kombëtar i Arsimit në Shqipëri – ndërtimi i një strategjie të plotë dhe të integruar të vlerësimit që mbulon vlerësimin kombëtar, vlerësimin nga mësuesit dhe shkollat, si dhe vlerësimet ndërkombëtare.
- ✓ Informimi i politikave arsimore përmes të dhënave, si dhe përdorimi i të dhënave nga vlerësimi për të informuar dhe kontribuar në politikat arsimore kombëtare.
- ✓ Njerëzit, Politikat, Programet dhe Investimet – përshtatja e strukturave dhe sistemeve të brendshme për të mbështetur një agjenci kombëtare efektive, me ndikim dhe të përgjegjshme.
- ✓ Përmirësimi i rezultateve të nxënësve dhe mundësive të studentëve – siguri që puna e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore të kontribuojë drejtpërdrejt në mundësi më të mira për studentët, përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe përfitime më të gjera socio-ekonomike.

Në zbatim të Memorandumi të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF) ka kontraktuar ekspertë britanikë nga Cambridge Assessment International Education, të cilët pasi kryen studimin në terren, propozuan transformimin e QSHA-së edhe variantin e krijimit të një Agjencie Autonome Kombëtare të Arsimit. Në zbatim të këtij projekti synohet që QSHA të kthehet në një nga institucionet më të mira në rajon e më gjerë dhe brenda disa viteve të marrë certifikatën ISO9001.

Sipas gjetjeve të ekspertëve, Qendra e Shërbimeve Arsimore duke u bërë autonome do të sigurojë cilësi më të lartë të vlerësimeve, procese më efikase dhe më shumë llogaridhënie.

Autonomia do t'i mundësojë QSHA-së të funksionojë pa ndikim nga institucioni epror, të modernizojë Maturën Shtetërore dhe vlerësimet e tjera, të përmirësojë menaxhimin e të dhënave dhe të lehtësojë njohjen e diplomave të huaja, të lehtësojë procesin e matrikullimit të studentëve, procese të cilat aktualisht pengohen nga burokracia.

Gjetjet e raportit të Cambridge Assessment International Education:

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore"

- Ka një nevojë të rëndësishme për vlerësim psikometrik të pyetjeve të përdorura në testin e pranimi të mjekësisë, pyetjeve të provimeve të shtetit dhe pyetjeve të Maturës Shtetërore, për të siguruar një kontroll më rigoroz të standardeve të vlerësimit. Ky vlerësim duhet të përfshijë teorinë e përgjigjeve të pyetjeve (IRT-Item Response Theory), lidhjen e pyetjeve dhe metrikat e të dhënave. Këto aftësi duhet të sigurohen përpara se të fillojë procesi i vlerësimit elektronik dhe përpara se të bëhet ndonjë dixhitalizim i mëtejshëm i vlerësimeve.
- Ka përfitime të konsiderueshme nga dokumentimi dhe analiza e detajuar e të dhënave midis QSHA dhe agjencive të ndryshme me të cilat bashkëpunon brenda sistemit të ndërlikuar të arsimit shqiptar. Të dhënat që shkëmbehen mes këtyre agjencive duhet të dokumentohen dhe të përdoren për të përmirësuar performancën e procesit në vitet e ardhshme.
- Procesi i njohjes së diplomave dhe kualifikimeve ndërkombëtare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë shqiptar po dëmton një numër studentësh ndërkombëtarë. Rektorët raportuan unanimisht se procesi zgjat shumë dhe se nuk ka gjithmonë një konsistencë në vlerësimet e aplikimeve individuale. QSHA ka punuar për të dixhitalizuar procesin dhe ka rregullore dhe Tregues Kryesorë të Performancës (KPI), por fokusi duket se është më shumë tek studentët kombëtarë sesa ata ndërkombëtarë. QSHA argumentoi se shkaku kryesor i vonës ishte dorëzimi i dokumentacionit të paplotë nga aplikantët. Megjithatë, mund të bëhet më shumë për të modernizuar plotësisht procesin dhe për të përmirësuar udhëzimet për studentët ndërkombëtarë, në mënyrë që të merren të dhëna të sakta dhe efektive nga aplikantët.
- Modernizimi i fundit i kurrikulës do të kërkojë ndryshime në Maturën Shtetërore, pedagogji, vlerësime dhe komunikim me aktorët e interesuar, siç janë prindërit, për të siguruar një përputhje të ngushtë midis kurrikulës dhe vlerësimit.
- E ardhmja e zhvillimit të vlerësimeve do të jetë dixhitale dhe jo në letër. Afatet kohore janë të pasigurta, por drejtimi është i qartë. QSHA duhet të përgatitet për këtë dhe të marrë në konsideratë ndikimin në të gjitha proceset e vlerësimit. Duhet gjithashtu të vlerësojë gatishmërinë dixhitale të të gjitha shkollave dhe qendrave të provimeve, pastaj të planifikojë dhe zbatojë zhvillimin e kapaciteteve dixhitale të shkollave/qendrave, duke i lidhur ato me një ofrim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të internetit, duke i pajisur me harduerin e nevojshëm dhe duke siguruar që stafi kyç i provimeve në

secilën qendër të trajnohet për të mirëmbajtur, riparuar dhe zgjidhur problemet teknike të pajisjeve dhe softuerëve.

- QSHA duhet të konsiderojë blerjen e një sasive të madhe laptopësh dhe furnizimin e tyre në shkollat publike për të mundësuar zhvillimin e provimeve PISA. Kjo do të reduktonte kohën e nevojshme për të plotësuar nevojat e çdo shkolle, duke eliminuar një proces të përvitshëm prokurimi dhe kërkimin e furnizuesve me stok të mjaftueshëm të pajisjeve cilësore, si dhe do të thjeshtonte logjistikën e shpërndarjes së laptopëve në shkolla.
- QSHA duhet të konsiderojë rekrutimin e disa prej vendeve aktuale vakante për të rritur numrin e stafit të përhershëm me kohë të plotë të disponueshëm për proceset që aktualisht kanë mungesë burimesh. Kjo do të eliminonte nevojën për rekrutimin dhe trajnimin e përvitshëm të stafit të përkohshëm, i cili është i kushtueshëm jo vetëm financiarisht, por edhe në aspektin e kohës dhe burimeve të trajnimit, dhe rrit rrezikun e cilësisë së ulët të punëve.
- Reduktimi i numrit të pyetjeve të fondit është efikas, pasi çon në përmirësimin e cilësisë së pyetjeve, duke bërë që testimet të jenë efektive dhe të sigurt, pa kompromentuar cilësinë.
- Rritja e përqindjes që zënë pyetjet kërkojnë një përgjigje më të thelluar. Përmirësimi i cilësisë së pyetjeve u jep mundësi nxënësve të mendojnë në mënyrë kritike.
- Përdorimi i listave të kontrollit mbi të gjithë procedurën e hartimit të pyetjeve, do të siguronte cilësinë e tyre.
- Ndryshimi i pikëzimit të pyetjeve të Provimeve të Shtetit, duke u dhënë të gjitha pyetjeve të njëjtën vlerë, 1 pikë, pavarësisht nivelit të tyre të vështirësisë. Duke qenë se pyetjet nuk janë të pilotuara, nuk garantohej saktësia në vlerësimin e vështirësisë së tyre.
- Trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve të vlerësimit mbi skemat e vlerësimit do të siguronte një proces më të saktë.
- QSHA duhet të sigurohet që një lëndë mos të jetë më e thjeshtë se të tjerat. Aktualisht ka lëndë të cilat jepen provim mature dhe zhvillohen vetëm në një vit (3 ore) dhe të tjera që zhvillohen në 3 vjet (8 orë).
- Mbledhja e të dhënave statistikore për të vlerësuar saktë vështirësinë e instrumenteve të vlerësimit.

- Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore në kompjuter, si për pyetjet me alternativa, ashtu edhe për pyetjet e hapura. Vlerësimi i pyetjeve me alternativa në mënyrë automatike u provua disa vite. Pati disa probleme për shkak se fleta e përgjigjeve ishte e ndarë nga testi dhe ndodhte që mbikëqyrësit nuk jepnin fletën e duhur (të lëndës ose variantit). Kjo sillte probleme në vlerësim. Një opsion mund të jetë që fleta e përgjigjeve të jetë bashkë me bookletin e testit.
- Vlerësimi i gjithë pyetjeve të testi me kompjuter do të siguronte më shumë cilësi, konfidencialitet dhe transparencë në vlerësim.
- Krijimi i një softueri për menaxhimin e fondit të pyetjeve, ku çdo bashkëpunëtor dhe specialist i QSHA të hyjnë me kredencialet e tyre, ku bashkëpunëtori do të ketë akses të kufizuar vetëm tek pyetjet e veta.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Kuadri ligjor kombëtar:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës.

Legjislacioni aktual për agjencitë autonome shtetërore, ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Krijimi i QSHA-së me ligj të posaçëm si person juridik, do të krijonte hapësirat ligjore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve në mënyrë autonome, duke përcaktuar rregulla, kritere si një agjenci autonome shtetërore, sipas ligjit 90/2012. Projektligji propozon organizimin dhe funksionimin e një agjencie autonome e cila do të kryejë funksionet administrative të përcaktuara në projektligj, të cilat plotësojnë së bashku këto kritere:

- a) nuk ka nevojë për drejtim dhe mbikëqyrje të përhershme e të drejtpërdrejtë nga ministri përgjegjës për arsimin, pasi vetë agjencia nëpërmjet organeve të brendshme do të ushtrojë realizimin e kompetencave të saj sipas praktikave më të mira ndërkombëtare duke përdorur ISO9001 – zbatimin e standardeve ndërkombëtare të sigurimit të

cilësisë për të implementuar praktikat më të mira në vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare.

- b) kërkon specializim të thellë në menaxhim, i cili nënkupton realizim të shërbimeve të saj në mënyrë autonome për të garantuar shërbime të pavarura për qytetarët, nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, institucionet e arsimit parauniversitar, institucionet e arsimit të lartë (IAL), urdhrat profesionalë, institucionet dhe të tretët, duke ushtruar në këtë lloj forme funksionin e saj teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave arsimore, mund të realizohet nga ky institucion në një nga format e organizmit të institucioneve të administratës shtetërore të përcaktuara në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Forma më e mirë e organizimit sipas këtij ligji, vlerësojmë se përcaktohet bazuar në një analizë të realizimit të funksioneve që aktualisht ofrohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në fushat që ajo mbulon duke referuar realizimin e secilit funksion sipas një forme më të përshtatshme të institucioneve të administratës shtetërore.

- c) financohet në mënyrë të balancuar nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e krijuara, i organizuar në formën e agjencisë autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin. Ajo do të ketë si burim financimi të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së Agjencisë, të ardhurat e krijuara nga tarifat e shërbimeve të ofruara tek të tretët, të ardhurat e krijuara nga tarifat e shërbimeve të administrimit të provimeve për profesionet e rregulluara si dhe të ardhurat e krijuara nga burime të tjera të ligjshme.

Për sa më lart, reformimi si agjencia autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin propozohet pasi funksionet administrative, të sipërcituara, realizohen më mirë nga kjo formë organizimi, sesa nga një ministri apo institucion varësie, në përputhje me parimin e ekonomisë, efikasitetit dhe të efektivitetit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS E BE-SË* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIV)

Projektligji nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGuese E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe përbëhet nga 4 krerë që kanë në përmbajtje 18 nene konkretisht si më poshtë:

Kreu I, parashikon dispozitat e përgjithshme dhe ka në përmbajtje nenet si vijon:

Neni 1 parashikon objektin e ligjit i cili parashikon krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, në vijim “Agjencia”, përcaktimin e fushës së saj të veprimtarisë, parimeve e rregullave të përgjithshme të organizimit e të funksionimit, si dhe detyrat dhe kompetencave të saj.

Neni 2 parashikon qëllimin e ligjit, i cili është përcaktimin e misionit dhe statusit të Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, dispozitat që sigurojnë autonominë organizative dhe financiare të Agjencisë në funksion të ofrimit të shërbimeve arsimore, duke siguruar cilësi, transparencë, efikasitet dhe efikasitet të vlerësimeve në interes të publikut.

Neni 3 parashikon misionin e Agjencisë, i cili është garantimi i interesit publik në ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit, profesioneve të rregulluara, vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nxitjen me synimin e përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe krijimin e kushteve të favorshme në interes të publikut.

Neni 4 parashikon fushën e veprimit të agjencisë, e cila ushtron veprimtarinë e saj për të gjithë territorin e vendit në fushën e shërbimeve të arsimit, të profesioneve të rregulluara, si dhe të administrimit të vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave arsimore, duke zbatuar standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kreu II parashikon krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së shërbimeve arsimore dhe ka në përmbajtje nenet si vijon:

Neni 5 parashikon statusin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore, e cila propozohet të jetë person juridik publik, i financuar në mënyrë të balancuar nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e krijuara, i organizuar në formën e agjencisë autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për arsimin. Agjencia ofron shërbime arsimore në përputhje me legjislacionin përkatës të secilit prej shërbimeve që ofron.

Neni 6 parashikon selinë, stemën dhe vulën e agjencisë. Selia e Agjencisë ndodhet në Tiranë. Agjencia mund të krijojë dhe degë territoriale me vendim të organeve të saj drejtuese. Stema e Agjencisë përbehet nga stema shtetërore e Republikës së Shqipërisë, me shënimin Republika e Shqipërisë, Agjencia e Shërbimeve Arsimore. Vulat e Agjencisë propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.

Neni 7 parashikon parimet e veprimtarisë së Agjencisë, e cila për arritjen e qëllimeve dhe për përmbushjen e kompetencave të parashikuara në këtë ligj, përgjatë veprimtarisë së saj, Agjencia ndjek dhe zbaton parimet e mëposhtme:

- a) ligjshmërisë;
- b) objektivitetit dhe paanësisë;
- c) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- d) paanësisë politike;
- e) bashkëpunimit ndërinstitucional;
- f) vlerësimit të drejtë dhe të barabartë të individëve;
- g) zbatimit të procedurave transparente;
- h) ushtrimit të veprimtarisë në mënyrë të paanshme, duke respektuar çështjet e konfliktit të interesave;
- i) administrimit me efikasitet, efektivitet dhe transparencë të fondeve financiare;
- j) garantimit të aksesit publik mbi të dhënat e publikueshme arsimore;

Neni 8 parashikon funksionet e agjencisë, e cila e mbështetet veprimtarinë e saj për ofrimin e shërbimeve arsimore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përmbush funksionet saj në përputhje me legjislacionin përkatës të secilit prej shërbimeve që ofron, si më poshtë:

- a) ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre, përmes analizave dhe studimeve që kryen;
- b) administron bazën e të dhënave shtetërore për arsimin parauniversitar;

- c) zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve;
- ç) kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar apo edhe testime ndërkombëtare të certifikuara;
- d) kryen procedurat e njëvlershmërisë/njësimit të dëftesave/diplomave të arsimit parauniversitar për nxënësit e ardhur nga jashtë vendit;
- dh) përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore dhe publikon raportet vjetore;
- e) administron bazën e të dhënave shtetërore për arritjet e nxënësve në provimet, vlerësimet kombëtare, i përpunon ato dhe informon ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe të interesuarit për rezultatet e arritjeve;
- ë) lëshon diplomën e maturës shtetërore, i cili është dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë;
- f) koordinon me institucionet e tjera, proceset e aplikimit dhe pranimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë për ndjekjen e programeve të studimit;
- g) krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve të studimit dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë;
- gj) kryen regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës për çdo program studimi në regjistrin shtetëror dhe lëshon aktin përkatës të regjistrimit;
- h) pajis çdo student të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë me numrin unik të matrikullimit;
- i) shërben si qendra kombëtare e rrjetit ENIC/NARIC (Rrjeti Evropian i Qendrave Kombëtare të Informacionit) për informimin e publikut dhe të interesuarve lidhur me procesin e njohjes dhe njësimit të diplomave brenda dhe jashtë vendit;
- j) kryen procedurat e njohjes dhe njësimit të diplomave të arsimit të lartë dhe të gradave shkencore, si dhe të njohjes së titujve akademikë, të fituar jashtë vendit;
- k) mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njohur në Republikën e Shqipërisë;
- l) organizon dhe administron provimin e shtetit për profesionet e rregulluara në bashkëpunim me autoritetet kompetente përkatëse;

- m) administron bazën e të dhënave shtetërore për provimet e shtetit dhe provimet e tjera të digjitalizuara;
- ll) ofron çdo shërbim tjetër të ngarkuar nga ministri përgjegjës për arsimin.

Në **nenin 9** parashikohen përcaktimet mbi buxhetin e agjencisë, ku burimet e financimit të saj përfshijnë si vijon:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) të ardhurat e krijuara nga kryerja e veprimtarisë së Agjencisë në zbatim të këtij ligji;
- c) të ardhurat e krijuara nga tarifatat e shërbimeve të ofruara te të tretët;
- ç) të ardhurat e krijuara nga tarifatat e shërbimeve të administrimit të provimeve për profesionet e rregulluara;
- d) të ardhurat e krijuara nga burime të tjera të ligjshme.

Agjencia financohet në mënyrë të balancuar nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj. Ajo ka të drejtën e përdorimit të 90 për qind të këtyre të ardhurave. Të ardhurat e papërdorura gjatë një viti financiar kalojnë në vitin pasardhës buxhetor.

Llojet dhe niveli i tarifave për shërbimet që Agjencia ofron për publikun miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Llojet dhe niveli i tarifave për shërbimet që Agjencia ofron për palë të treta, përfshirë subjektet private, miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

Projektbuxheti vjetor i Agjencisë hartohet nga drejtori i përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.

Buxheti vjetor i Agjencisë përdoret në mënyrë autonome, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për menaxhimin buxhetor dhe financiar.

Agjencia përgatit çdo vit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit financiar. Pasqyrat financiare vjetore i paraqiten Këshillit Drejtues si pjesë e raportit të veprimtarisë vjetore dhe mbulojnë një periudhë njëvjeçare kalendarike.

Në **nenin 10** parashikohet organizimi i drejtimit të agjencisë, ku struktura drejtuese e Agjencisë përbëhet nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Drejtori i Përgjithshëm është titullari i Agjencisë dhe emërohet nga Këshilli Drejtues sipas kriterëve dhe procedurave të miratuara nga ky Këshill.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë ushtron detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

- a) harton dhe i paraqet për miratim Këshillit Drejtues dokumentet strategjike dhe të planifikimit, për ofrimin e shërbimeve arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- b) harton metodologjinë e ofrimit të shërbimeve arsimore dhe propozon ndryshimin e mëtejshëm të kësaj metodologjie, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi;
- c) siguron ofrimin e shërbimeve arsimore në përputhje me standardet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ç) siguron kryerjen e ofrimit të shërbimeve arsimore në mënyrë autonome, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paañësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- d) mbikëqyr zbatimin e rregullave e të procedurave për parandalimin e konfliktit të interesit;
- dh) përgjigjet për hartimin e sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm, në përputhje me praktikat më të mira në fushën e kompetencave që mbulon;
- e) monitoron sistemet e qeverisjes e të kontrollit të brendshëm për të siguruar që këto sisteme të funksionojnë në mënyrë efektive;
- ë) harton raportin vjetor të veprimtarisë, i cili mbulon aktivitetet e Agjencisë gjatë vitit raportues dhe përfshin raportimin mbi funksionimin efektiv të sistemeve të qeverisjes e të kontrollit të brendshëm, dhe pas miratimit nga Këshilli Drejtues e paraqet në ministrinë përgjegjëse për arsimin.
- f) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët;
- g) paraqet projekt-buxhetin vjetor pranë Këshillit Drejtues të Agjencisë;
- gj) i propozon Këshillit Drejtues projekt-strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;
- h) kryen vlerësimin e performancës së stafit;
- i) paraqet për miratim të Këshillit Drejtues rregulloren e brendshme të funksionimit dhe administrimit të Agjencisë;
- j) propozon strukturën organizative, përshkrimet dhe kërkesat për çdo pozicion pune si dhe kriteret e punësimit të personelit, në përputhje me Kodin e Punës dhe me rregulloren e tij të brendshme, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit Drejtues.
- k) emëron personelin e nevojshëm administrativ, sipas kriterëve të përcaktuara dhe mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit;
- l) ushtron detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë mbështetet nga zëvendësdyrëtorët, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i Agjencisë, me të njëjtat kritere dhe procedura sikurse dhe Drejtori i Përgjithshëm.

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të emëruar për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë:

- a) 2 (dy) anëtarë janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, nëpërmjet drejtuesve të nivelit të lartë të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- b) 2 (dy) anëtarë janë përfaqësues të emëruar nga donatorë/partnerë zhvillimorë të përzgjedhur, me të cilët ministria përgjegjëse për arsimin ka lidhur marrëveshje të posaçme bashkëpunimi për rritjen e kapaciteteve të Agjencisë;
- c) 1 (një) anëtar, ekspert me përvojë ndërkombëtare në fushën e shërbimeve të testimit dhe vlerësimit të sistemeve arsimore, i përzgjedhur përmes një procesi publik përzgjedhjeje me thirrje të hapur.

Donatorë/partnerët zhvillimorë janë organizatat publike apo private, me status jo fitimprurës, kombëtare apo ndërkombëtare të cilat mbështesin projekte arsimore, për realizimin e qëllimeve të këtij ligji dhe për zbatimin e projekteve që përmirësojnë fushat e veprimtarive që ushtrohen nga agjencia, me të cilët ministria ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

Këshilli Drejtues merr vendime me tre të pestat (3/5) e të gjithë anëtarëve dhe ka këto kompetenca:

- a) miraton programet e punës vjetore dhe strategjike të Agjencisë;
- b) me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm miraton buxhetin e Agjencisë;
- c) miraton strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë, të parashikuara nga Drejtori i Përgjithshëm;
- ç) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të Agjencisë;
- d) i propozon ministrisë përgjegjëse për arsimin, llojet e shërbimeve publike dhe masat e tarifave përkatëse, që ofron Agjencia, për miratimin e tyre me vendim të Këshillit të Ministrave;
- dh) llojet dhe masa e tarifave për shërbimet për të tretët, subjekte private, përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë;
- e) monitoron efikasitetin dhe efencën e shërbimeve të ofruara përmes raportimeve periodike nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë;
- ë) ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- f) miraton kriteret dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve;
- g) emëron dhe shkarkon Drejtorin dhe Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorët;
- h) merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Anëtari i përcaktuar në pikën 5, shkronja "c" të këtij neni, përzgjidhet përmes një procesi konkurrimi të hapur nga një komision i përbashkët i përbërë nga 2 (dy) përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe 1 (një) përfaqësues i Donatorëve/ partnerëve zhvillimorë. Emërimi i ekspertit të përzgjedhur nga komisioni bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

Në **nenin 11** parashikohen dispozita mbi stafin e agjencisë, ku marrëdhëniet e punës së nëpunësve dhe punonjësve të Agjencisë rregullohen nga Kodi i Punës, rregullorja e brendshme e funksionimit dhe administrimit të Agjencisë, si dhe aktet e brendshme të saj.

Punonjësit e Agjencisë duhet të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, Kodin e Punës, rregulloren e brendshme të institucionit, standardet e ofrimit të shërbimeve arsimore dhe Kodin e Etikës së institucionit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Në **nenin 12** parashikohet bashkëpunimi ndërinstitucional i agjencisë e cila për arritjen e qëllimeve dhe ushtrimin e suksesshëm të funksioneve të saj, Agjencia bashkëpunon, bashkërendon dhe i harmonizon veprimtaritë e saj me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me institucionet publike dhe private të arsimit si dhe me organet e institucionet e tjera shtetërore.

Gjithashtu Agjencia bashkëpunon me partnerët, donatorët, organizatat homologe të huaja, me organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e arsimit, për shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, zbatimin e modeleve të suksesshme, për zgjerimin e veprimtarisë dhe shërbimeve të ofruara prej saj, me synimin për të qenë një qendër reference kombëtare për administrimin e vlerësimit e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare e ndërkombëtare.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj Agjencia, ka të drejtë të kërkojë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e funksioneve të saj. Organet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë, të shkëmbejnë informacion dhe të sigurojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme, për përmbushjen e kompetencave dhe detyrimeve të

Agjencisë.

Në **kreun III**, parashikohen dispozita mbi mbikëqyrjen dhe kontrollin e agjencisë dhe ka në përmbajtje nenet si vijon:

Në **nenin 13** parashikohet mbikëqyrja e agjencisë, e cila në veprimtarinë e saj mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për arsimin e cila verifikon zbatimin korrekt të politikave dhe strategjive kombëtare në fushën e arsimit.

Për qëllimet e mësipërme lidhura me mbikëqyrjen dhe kontrollin, Agjencia i dorëzon ministrit përgjegjës për arsimin, raportin vjetor mbi veprimtarinë e saj, brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Agjencia raporton vullnetarisht tek ministria përgjegjëse për arsimin, sa herë që e sheh të nevojshme, lidhur me analizën e rezultateve, problematikat dhe çdo informacion tjetër të dobishëm për përmirësimin e shërbimeve arsimore.

Agjencia ka detyrimin të raportojë, kur i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, edhe për çështje të tjera apo për çdo të dhënë të kërkuar nga ministria.

Në **nenin 14** parashikohet kontrolli i agjencisë, i cili realizohet nga ministria përgjegjëse për arsimin e cila ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi respektimin e niveleve dhe standardeve të shërbimeve, që ofrohen Agjencia në çdo kohë. Kontrollat janë me natyrë tematike, rastësore, ligjshmërie dhe financiare. Raportet e kontrollit dhe rekomandimet e nxjerra janë të detyrueshme për tu zbatuar nga Agjencia.

Në **kreun IV** parashikohen dispozitat e fundit dhe kalimtare dhe ka në përmbajtje nenet si vijon:

Në **nenin 15** parashikohen dispozitat kalimtare mbi përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues, e cila përcakton se brenda gjatë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministri dhe donatorët/partnerët zhvillimorë e përzgjedhur emërojnë anëtarët e Këshillit Drejtues.

Në mungesë të donatorëve/partnerëve zhvillimorë, përzgjedhja e ekspertit, anëtar i Këshilli Drejtues të Agjencisë, bëhet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Qendra e Shërbimeve Arsimore, vijon veprimtarinë e saj deri në riorganizimin e plotë në Agjenci të Shërbimeve Arsimore.

Në **nenin 16** parashikohet miratimi i akteve nënligjore në zbatim të projektligjit të propozuar.

Në nenin 17 parashikohet shfuqizimi i neneve 9 dhe 10 si dhe pikat 3, 5 dhe 7 të nenit 92 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 18 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit, i cili hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri janë ministria e Arsimit dhe Sportit dhe agjencia e shërbimeve arsimore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 307, datë 24.6.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore””, i ndryshuar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ne lidhje me efektet financiare të projekt ligjit të QSHA-se, Ministria e Arsimit dhe Sportit aktualisht financoi Qendrën e Shërbimeve Arsimore për procesin e Maturës Shtetërore dhe vlerësimin e provimeve të ciklit 9-vjeçar, në shumën totale prej 30.000.000 lekë/vit. Të gjitha shpenzimet e tjera, përfshirë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, përballohen nga të ardhurat e veta. Në varësi me statusin juridik të ASHA-n, (Agjenci autonome apo me financim të balancuar nga buxheti) do të përlogariten efektet financiare konkrete pasi aktualisht është e pamundur të përlogariten.

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU